



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

OSHP. Nr.2024/0640

Data e vendimit: 25.07.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik N.P.T. "Bajra", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me paisje kundër zjarrit" me numër të prokurimit 632-24-4689-1-2-1, iniciuar nga Komuna e Gjakovës në cilësinë e autoritetit kontraktues, ud. Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Agim Sheqiri me datën: 25.07.2024, mori këtë:

VENDIM

- I. Hedhet si e palejuar** (parakohshme) ankesa e OE N.P.T. "Bajra". me nr. të protokollit 2024/0640, e datës 16.07.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me paisje kundër zjarrit" me numër të prokurimit 632-24-4689-1-2-1, iniciuar nga Komuna e Gjakovës, nga cilësia e tij/saj si autoriteti kontraktues (AK).
- II.** I lejohej, autoritetit kontraktues – Komuna e Gjakovës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me paisje kundër zjarrit" me numër të prokurimit 632-24-4689-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

ARSYETIM

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 16.07.2024 ka pranuar ankesën me nr.2024/0640 nga N.P.T. "Bajra". lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me pajisje kundër zjarrit" me numër të prokurimit 632-24-4689-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me pajisje kundër zjarrit" me numër të prokurimit 632-24-4689-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës me datë 14.05.2024 është publikuar B05 Njoftimin për kontratë dhe OE ankues N.P.T. "Bajra". nuk ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.

OE ankues nuk ka kundërshtuar paraprakisht Vendimin e AK-së përmes Kërkesë për Rishqyrtim dhe i njëjti drejtpërsëdrejti i është drejtuar me ankesë OSHP-së

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së pas pranimit të vendimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, brenda afateve ligjore të parashtrajnë kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 1 i LPP-së përcakton se: "*Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*" Ndërsa neni 109 i LPP-së përcakton se: "*Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrajë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji lidhur me nenit 59 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj si e tillë hedhet si e pa lejuar në kuptimin si e parakohshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.*"

AK - Komuna e Gjakovës -, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me pajisje kundër zjarrit" me numër të prokurimit 632-24-4689-1-2-1, megjithatë OSHP i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK ,duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Po ashtu, zyra për financa, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë

e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Ud. Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Gjakovës

1x1 OE - N.P.T. "Bajra".

1x1 Arhivës së OSHP-së;

Agim SHEQIRI
Ud. i Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së

